

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Fjalimi i Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

Hazret Mirza Masroor Ahmedit

Mbajtur në Konferencën vjetore ndërkombëtare në Islamabad, afër Londrës më

31 Korrik 2004

Progresi i Ahmediatit

Hazuri tha se është bërë praktikë që në ditën e dytë të Xhalsa Salanës¹ t'i përmendim bekimet e Allahut të shfaqura në dobi të Xhematit Ahmedia gjatë vitit të kaluar. Ndoshta pikat e shiut mund të numërohen, por bekimet e Allahut të Madhërishëm mbi Xhematin e Tij janë aq të shumta sa që nuk mund të numërohen. Zemra mbushet me mirënjohje dhe falënderim për Allahun e madhërishëm kur shohim përbushjen e premtimeve që Ai ia ka dhënë Mesihut të Premtuar^{as}. Për çdo ditë po zbresin mbi ne bekimet dhe mirësitë e të Madhërishmit^{xhh} dhe fjalët e Mesihut të Premtuar^{as} shfaqen para syve tanë, kur iu drejtua Allahut^{xhh} dhe i tha: ***“Ti je besnik në premtimet Tua, o Zoti im”!*** Duke i parë këto bekime të panumërta të Allahut të Madhërishëm, zemra përulet me mirënjohje dhe falënderim ndaj Tij.

Asnjë anëtar dhe shërbëtor i Xhematit nuk mendon dhe nuk duhet të mendojë se progresi i Xhematit është si rezultat i përpjekjeve tona. Nëse është si rezultat i ndonjë gjëje, atëherë është vetëm si rezultat i mirësisë së Allahut^{xhh}. Në përbushje të premtimeve që Allahu ia ka dhënë Mesihut të Premtuar^{as}, ne i kemi pranuar këto bekime dhe po i pranojmë edhe sot. Hazuri më tutje tha se ajeti i Kuranit të Shenjtë që e recitova në fillim thotë se ***‘armiqtë dëshirojnë ta shuajnë dritën e Allahut, por Allahu ka premtuar se do ta plotësojë manifestimin e bekimeve Tij.***

Tani, tha Kalifi, unë do flas në pika të shkurta rreth këtyre bekimeve që Allahu^{xhh} i ka zbritur mbi Xhematin tonë gjatë vitit që po e lëmë pas. Allahu i Madhërishëm i ka dhënë Mesihut të Premtuar një Xhemat të shkëlqyer që bën sakrifica gjigante në rrugën e Allahut.

¹ Konferencës vjetore tri ditore të Xhematit Islamik Ahmedia

Unë tani do t'i përmend vetëm disa të arritura në fushën e sakrificave financiare. Xhemateve të vendeve të ndryshme u janë dhënë objektiva të ndryshme në përputhje me kapacitetet e tyre. Sipas raporteve që na kanë ardhur, jo vetëm që plani është përmbushur, por në fakt ai është tejkaluar për 24,5 %. Hidhni për një çast një vështrim historisë, kur armiqtë e Xhematit përbetoheshin se Xhemati dhe anëtarët e tij do të shndërroheshin në lypsa dhe do t'i shtrijnë duart rrugëve për lëmoshë.

Por, çka ndodhi?

Sot Allahu u ka mundësuar juve që të sakrifikoni në rrugën e Tij me miliona e biliona.

Xhemati i SHBA-ve i ka tejkaluar parashikimet për 30%, Xhemati i Gjermanisë për 15%, Kanadaja për 12,5%. Pastaj: Belgjika, Suedia, Franca, etj. i kanë përmbushur dhe tejkaluar premtimet e tyre. Në vendet Afrikane, Gambia i ka tejkaluar premtimet e veta për 26%. Në vende të ndryshme të botës, anëtarët tanë i janë kthyer sakrificave financiare me vullnet të paparë.

Kjo ishte shkurtimisht sa i përket sakrificave financiare, dhe tani do të përmend vendet e reja në të cilat Xhemati është themeluar. Elhambulilah, në 178 vende të botës Xhemati Ahmedia është themeluar në mënyrë të mirëfilltë. Në 20 vitet e fundit, kur opozitarët tanë kanë bërë të pamundshmen për ta shkatërruar Xhematin, Allahu i Madhërishëm me mirësinë e Tij ia ka dhënë 87 vende të reja Xhematit Ahmedia. Kam qenë i brengosur se ndoshta këtë vit listës nuk do t'i shtohet ndonjë vend i ri, por Allahu^{xhh} i ka mënyrat e veta për ta bekuar Popullin e Tij, dhe kështu në këtë vit Xhemati është stabilizuar edhe në dy vende të reja: në Seint Kitc Nevis dhe Martinik.

Seint Kitc Nevis i ishte caktuar Xhematit të Trinidadit. Amiri i këtij vendi e dërgoi atje një delegacion dhe, elhambulilah, përpjekjet filluan të japin frute. Pastaj një familje gjashtë anëtarësh që jetonte në Trinidad emigroi në Seint Kitc Nevis dhe tani një xhematë është themeluar në atë vend dhe insha'allah raportet do të tregojnë rezultate të mira. Pastaj Martiniku është një shtet ujdhesë në të cilin anëtarët e Xhematit të Francës kanë predikuar. Ai gjendet në veri të Trinidadit. Një delegacion nga Franca ishte dërguar atje të cilët organizuan radio-programe, takime Pyetje & Përgjigje, etj. dhe si rezultat dy persona u konvertuan. Tani predikimi ka marrë hov dhe, elhamdulillah, edhe gjashtë persona të tjerë janë anëtarësuar dhe i janë bashkuar Xhematit.

Tani do të përmend xhematet e reja lokale brenda shteteve që janë themeluar këtë vit. Jashtë Pakistanit, 354 xhematë lokale janë themeluar gjatë vitit që po e lëmë pas. Krahas kësaj, 188 degë të reja gjithashtu janë themeluar në lokacione të ndryshme. Pra, 542 xhematë të reja janë stabilizuar në zona të ndryshme. 151 degë të reja janë themeluar vetëm në Indi, pastaj në Burkina Faso gjithashtu është shtuar numri i xhematëve lokale, në Sierra Leone 18 degë të reja, disa në Tanzani, Nigeri, Ghana, Indonezi, etj.

Amiri i Xhematit të Francës na ka informuar se në një qytet të quajtur Bakoni kontakte të reja janë krijuar. Para një kohe, ai u ftua nga një person për një vizitë në këtë qytet. Pas një udhëtimi të gjatë, kur arriti atje me dy sekretarët e tij, personi që i kishte ftuar, kishte dërguar djalin e tij për t'i pritur, i cili kishte insistuar që të shkonin në shtëpi. Ai tregon se kur arritëm në shtëpinë e tij, pamë MTA-në që po shikohej, ndërsa në mur pamë fotografitë e Kalifit të Katërt dhe të Pestë. U befasova dhe thashë më vete se këta qenkan konvertuar.

Në kohën kur Xhemati ishte duke i shërbyer çështjes së Bosnjes, ky njeri ishte konvertuar, por më vonë e kishte humbur kontaktin me Xhematin. Ai është murator me profesion dhe tha se një ditë kur po punoja, e ktheva shikimin nga qielli dhe u luta: “O Allah! E kam çuar dëm jetën time vetëm në kërkim kësaj bote. Dua të vihem përsëri në kontakt me ahmedianët. Të lutem më ndihmo që kjo të ndodhë!” Ai kishte ftuar edhe familje të tjera për të na takuar, me të cilët diskutuam dhe si rezultat tri familje të tjera u konvertuan.

Pastaj rreth progresit në ndërtimin e Xhamive. Gjatë vitit, me ndihmën e Allahut^{xhh}, numri i xhamive është shtuar për 162 sosh. 74 janë ndërtuar të reja dhe 88 të tjera kanë ardhur si rezultat i konvertimit. Prej vitit 1984 kur në Pakistan u lëshua dekreti që ahmedianët nuk ishin myslimanë dhe filloi fushata për shkatërrimin e Xhematit Ahmedia, prej atëherë 13457 xhami të reja janë ndërtuar nga Xhemati Ahmedia. Kjo është vetëm nga mirësia e Allahut. Nga këto 11560 xhami i janë dhënë Xhematit me gjithë adhuruesit dhe imamët e tyre si rezultat i konvertimit.

Në Çikago të Amerikës një xhami u përfundua dhe ka kushtuar dy milion e gjashtëqind mijë dollarë. Në Hjuston, gjithashtu, është ndërtuar një xhami e re. Tani në SHBA, Xhemati ka 15 xhami, ndërsa 4-5 troje janë blerë dhe në disa prej tyre xhamitë janë në ndërtim e sipër. Në Kanada, vitin e kaluar, në periferi të Torontos në një vend shumë të rëndësishëm, Xhemati e ka blerë një copë toke dhe insha'allah ndërtimi do të fillojë së shpejti. Pastaj në Seint Katerine një copë tjetër toke është blerë gjithashtu. Edhe një truall shumë i bukur është blerë për ndërtimin e një shkolle.

Në Britani të Madhe, me ndihmën e Allahut, është kompletuar këtë vit Xhamia e famshme Baitul Futuh. Shtypi botëror i ka dhënë publicitet të jashtëzakonshëm dhe duket se kjo ka qenë një mirësi e veçantë e Allahut të Madhërishtëm. Në Birmingham gjithashtu një xhami është përfunduar, ndërsa në Hartlipul dhe Bradford dy xhami të reja do të ndërtohen. Në Indi, gjatë vitit, 29 xhami të reja janë ndërtuar dhe numri i xhamive në këtë vend ka arritur 2054. Në Bangladesh gjithashtu 3 xhami të reja janë përfunduar. Armiqësia e hoxhallarëve ka arritur kulmin në Bangladesh. Lutuni për anëtarët tanë atje që Allahu t'i mbajë nën mburojën e Tij. Edhe në Indonezi një xhami e re është ndërtuar dhe tani numri i xhamive atje ka arritur në 367. Kamboxha gjithashtu ka

ndërtuar një xhami të re. Ghana ka ndërtuar disa xhami gjatë këtij viti. Gjatë vizitës sime para disa muajsh kam inauguruar 11 xhami dhe dy të tjerave ua kam vënë gurthemelin. Në Nigeri gjithashtu 9 xhami të reja janë ndërtuar ndërsa 8 i janë dhënë xhematit përmes konvertimit. Unë i kam këshilluar ata që kudo që janë themeluar xheme të reja të ndërtohen xhami. Në Siera Leone 16 xhami të reja janë ndërtuar. Në Senegal deri tani 84 xhami janë ndërtuar. Në Gambia dy xhami të reja janë ndërtuar. Në Madagaskar vitin e kaluar xhamia e parë është ndërtuar ndërsa këtë vit dy xhami të tjera janë ndërtuar. Në Kongo katër. Në Uganda 7. Xhematit të Kenisë i është dhënë objektivi për ndërtimin e 100 xhamive, dhe me ndihmën e Allahut ata i kanë përfunduar 51 xhami deri tani. Xhematit të Tanzanisë gjithashtu i është dhënë plani për ndërtimin e 100 xhamive dhe deri tani ata i kanë ndërtuar 42, ndërsa 3 janë në ndërtim e sipër.

Burkina Faso i ka kompletuar 5 xhami. Gjatë turneut tim në atë vend i kam inauguruar 3 prej tyre. Në Benin dy xhami të reja janë ndërtuar. Në Kotonou – kryeqytetin e Beninit një xhami shumë e bukur është ndërtuar buzë autostradës e cila gjithashtu u inaugurua gjatë turneut tim. Pastaj në veri të Beninit në Peroku xhamia e parë, Baitul Afija u ndërtua dhe një xhamie në Potonovo iu vu gurthemeli. Krejtësisht 11 xhami janë duke u ndërtuar në Benin. Në njëzetë vitet e fundit në Pakistan kundërshtarët ose i kanë shkatërruar disa nga xhamitë tona ose i kanë mbyllur. Në përgjigje të kësaj, i Plotëfuqishmi^{xhh} i ka dhuruar Xhematit Ahmedia 13457 xhami të tjera. Ne jemi nën përkujdesjen dhe mbrojtjen e Allahut të Madhërishëm. Kundërshtarët tanë mendojnë se janë duke na luftuar neve, por le ta dinë se janë duke e luftuar Allahun^{xhh}. Ata duhet të kenë frikë nga hidhërimi i Tij^{xhh}, sepse mbi kë zbret hidhërimi i Allahut, atij as shenja nuk do t'i gjendet.

Amiri i xhematit të Fixhit shkruan se në një ujdhesë të quajtur Raveni ata u përpoqën të gjenin ndonjë vend për të ndërtuar një xhami dhe u ballafaquan me shumë vështirësi. Para pak kohe i shkruan Hazurit për dua. Pas një kohe të shkurtër, ndihma e Allahut^{xhh} erdhi dhe ata morën një letër nga komuna ku u jepej leja për të ndërtuar xhaminë dhe tani ndërtimi ka filluar.

Mubarak Mahmud Sahibi na ka informuar se buzë autostradës që shkon prej Darus Salamit për në Rusa, është një fshat në të cilin xhema ishte themeluar para një kohe. Edhe vetë kryetari i fshatit e kishte pranuar Ahmediatin. Një anëtar i devotshëm e kishte ofruar një godinë për nevojat e Xhematit. Por, problemi kryesor aty ishte opozita e rreptë. Aty ishte edhe një xhami e joahmedianëve ku hoxhallarët opozitarë mblidheshin nga vende të ndryshme dhe duke përdorur gjuhë të ndytë mundoheshin t'i nxitnin njerëzit kundër Xhematit.

Por si veproi Allahu?

Qeveria vendosi të ndërtonte një autostradë që do të kalonte fare pranë dhe sipas rregullores ndërtimi në afërsi të caktuar në dy anët e autostradës nuk lejohej. Si

rezultat, qeveria e rrafshoi xhaminë e joahmedianëve, ndërsa xhamia e Xhematit, që ishte vetëm pakë më larg autostradës nuk u prek.

Pastaj, 159 qendra janë ndërtuar. Në Indonezi disa qendra të reja janë hapur, në Amerikë gjithashtu, në Gijana, në Ghana, Nigeri, Tanzani, etj. Koha është e kufizuar për t'i përmendur të gjitha. Në Burkina Faso një kompleks i tërë është kompletuar. Vetëm para disa viteve, ata faleshin nën një kulm llamarine. Pastaj Allahu u dha mundësi të ndërtojnë një kompleks të tërë ku gjendet një Xhami, një Shtëpi Misioni, një apartament për Misionarin dhe një spital i madh. Vetëm disa ditë para turneut tim ishte kompletuar ky kompleks dhe pastaj e inauguroam. Anëtarët e xhematit punuan ditë e natë deri sa e përfunduan. Allahu i shpërbleftë të gjithë ata që kanë derdhur djersë aty. Edhe në Francë dy Qendra të reja janë blerë. Në Gjermani gjithashtu, në Britani të Madhe në lindje të Londrës, etj.

Tani do të flas diçka rreth përkthimeve të Kuranit të shenjtë. Deri në vitin e kaluar kanë qenë 57 përkthime të Kuranit të shenjtë në gjuhë të ndryshme të botuara nga Xhemati Ahmedia. Para disa ditësh, me delegacionin që erdhi nga Kadijani, më erdhi edhe një përkthim tjetër i Kuranit në njërën nga gjuhët e Indisë. Tani, kemi 58 përkthime në gjuhë të ndryshme të botës. Përkthimi i Kuranit në gjermanisht është ripublikuar. Në gjuhën tai, janë publikuar dhjetë volume të Kuranit me komentim si dhe një edicion i ri i përkthimit të Molana Sher Ali Sahibit. Përkthimi në breil është përgatitur gjithashtu. Përkthimet në holandisht dhe anglisht janë ripublikuar. Në përkthimin e Kuranit, momentalisht është duke u punuar në gjuhët e këtyre vendeve: të Mauriciusit, Hungarisë, Kazakistanit, Kenisë, Kongos, Fixhit, Gini Bisausë, Lituanië, Uzbekistanit, Ghanës, Indisë, pastaj në gjuhën dako të Nigerisë, në gjuhën fanti, more, sinhala, khamir nga Kambogjja, samojan, kargaz të Kargizistani, dhe argono të Beninit. Disa përkthime është dashur të korrigjohen dhe tani janë në publikim e sipër.

Gjatë vitit, në 26 gjuhë të ndryshme, janë botuar libra dhe pamflete. Është ribotuar **“Komentimi i Sures Fatiha”** me disa përmirësime. Kjo është një përmbledhje nga shkrimet e Mesihut të Premtuar, që ishte përkthyer në anglisht nga Çodri Zafrullah Khan Sahib. **“Tadhkira”** gjithashtu është ripublikuar. Edhe libri në gjuhën arabe i Mesihut të Premtuar **“Aina kamalati Islam”** është përkthyer dhe publikuar në anglisht. Pastaj **“Toziimram”**, një libër tjetër i Mesihut të Premtuar^{as} është përkthyer në anglisht nga Çodri Muhamed Ali Sahib dhe është botuar këtë vit. Lutuni për të, sepse me gjithë moshën e shtyrë dhe lëngimet nga shumë sëmundje, ai është duke punuar si një djalë i ri. Allahu e bekoftë dhe i dhëntë jetë të gjatë e të shëndoshë.

Hazuri tha pastaj se kam shumë libra këtu, por jam duke ua prezantuar vetëm disa prej tyre. Pastaj nga **Malfuzatet** e Mesihut të Premtuar, fragmente të zgjedhura janë ripublikuar nën titullin **“Esenca e Islamit”** tani me disa

korrektive dhe përmirësime. Një ekip i tërë ka punuar në SHBA për ta nxjerrë në dritë këtë përmbledhje. Edhe disa volume të tjera me po të njëjtin titull janë të gatshme për botim. Dy i kam këtu, ndërsa e treta është në shtypshkronjë dhe, insha'allah së shpejti do të dalë në dritë. *“Fjalimi i Sialkotit”* dhe *“Mesihu në Indi”* janë përkthyer në gjuhën bangla. Në danisht është përkthyer libri i Kalifit të Katërt *“Islami dhe problemet e botës bashkëkohore”*. Pastaj një libër rreth jetës së Kalifit të Parë është botuar në anglisht. Shumë anëtarë kanë kërkuar që të botohen në formë libri një seri fjalimesh që i kamë mbajtur rreth kushteve të Bejtit dhe përgjegjësive të anëtarëve të Xhematit. Me kërkesën e tyre ky libër tani është botuar. Pastaj libri i Kalifit të Katërt *“Revelation...”* është përkthyer në arabisht nga Mustafa Sabit Sahib, i cili me gjithë sëmundjen e tij, ka punuar me vetëmohim. Ai vuan nga një sëmundje serioze, por megjithëkëtë ka punuar shumë dhe meriton shumë lutje. Tani ai është duke punuar në përkthimin në arabisht të pesë volumeve me komentim të Kuranit të shenjtë. *“Islami dhe domethënia e tij për njeriun bashkëkohor”* është një libër i shkruar në anglisht nga Çodri Zafrullah Khan Sahibi, i cili tani është ribotuar. *Laxhna imailah* nga Pakistani² e ka botuar librin *“Durre Samiin”* me një fjalorth. Edhe në Kadijan janë botuar disa libra.

Kam kërkuar nga anëtarët e Xhematit të paraqiten për të ndihmuar në përkthimin e veprave të Mesihut të Premtuar^{as} dhe që tani, shumë janë lajmëruar dhe i kanë ofruar shërbimet e tyre. Pastaj, për ta rregulluar nocionin e gabuar, që bota e ka krijuar rreth xhihadit një broshurë të re, është përgatitur dhe publikuar në 25 gjuhë ku tregohet se Islami është religjion paqësor.

Sahih Buhari është përkthyer në anglisht nga Sajid Valiullah Shah Sahib dhe tani është gati për publikim. Pastaj fjalët e Kuranit të shenjtë janë përgatitur në formë fjalori me përkthim në anglisht e cila gjithashtu është gati për shtyp. Pastaj librat e Mesihut të Premtuar^{as} *“Dexhalijate ilaija”*, *“Kashtie Nuh”*, *“Hakikatul Vahi”*, *“Asmani Fesla”*, *“Lecture Sialkoot”*, *“Maxharul Mazahib”*, *“Azala Oham”*, *“Ishatul Kuran”*, janë duke u përkthyer. Në secilin libër të Mesihut të Premtuar^{as}, përkthyesit punojnë, nganjëherë, me vite të tëra. Pra, një punë e madhe është duke u bërë në këtë drejtim.

Ekspozitat e Kuranit të shenjtë dhe e librave të tjera është një mënyrë shumë e mirë për ta përçuar mesazhin e Islamit. 252 ekspozita të tilla janë përgatitur në Indi, Portugali, Britani të Madhe, etj. Vendet tjera duhet gjithashtu të përpiqen të përgatisin ekspozita të tilla, sepse ato janë një mjet i shkëlqyeshëm për përhapjen e mesazhit. Edhe tezgat dhe panairt e librave janë gjithashtu shumë të dobishme për transmetimin e mesazhit të Islamit. Këto janë gjithashtu shumë të dobishme për krijimin e kontakteve të reja. 2936 panairt dhe tezga të tilla librash janë mbajtur në Gjermani, Tanzani, Zvicër, Holandë, etj.

²⁾Shoqata e grave brenda Xhematit.

Edhe shtypshkronja e Xhematit *Rakeem Press* është duke bërë një punë të madhe. Ajo ka degët e veta në shumë vende si: Ghanë, Nigeri, Gambi, Sierra Leone, etj. Tani puna është shtuar aq shumë sa që në Ghanë dhe Nigeri godina të reja janë duke u ndërtuar për zgjerimin e shtypshkronjës. Nga Rakeem Press Islamabad (në afërsi të Londrës) mbi 200 000 libra janë botuar. Edhe në Afrikë mbi 200 000 libra dhe pamflete janë botuar. Në Bregun e Fildishtë, Xhemati ka gjithashtu një shtypshkronjë, ku krahas botimeve të tjera, botohet edhe *Rewiev of Religions* në frëngjisht, për t'u dërguar më pas në të gjitha vendet frankofone. Shtypshkronja nganjëherë merr përsipër edhe punë me pagesë. Na kanë raportuar se një ditë Ministri i Jashtëm i Tanzanisë pati nevojë për publikimin e një raporti në formë libri i cili duhej të botohej brenda njëzet e katër orëve. Shtypshkronjat shtetërore refuzuan dhe ata erdhën te shtypshkronja e Xhematit me kërkesën e tyre. Pasi e pranuan punën, anëtarët e Xhematit punuan gjatë gjithë natës deri sa e përfunduan. Ata mbetën të mahnitur. Ata nuk e dinë se kur punëtorët e Xhematit fillojnë të bëjnë diçka, me trajnimin shpirtëror që kanë, nuk brengosen se a është ditë apo natë, ndërsa të tjerët nuk mund të sakrifikojnë kaq shumë.

Në arabisht, 40 libra dhe pamflete janë botuar.

Amiri i Gambisë ka raportuar se disa joahmedianë thanë se ahmedianët nuk guxojnë t'i afrohen xhamisë sonë, sepse janë mëkatar dhe të papastër. Ahmedianët e raportuan çështjen në Gjykatën rajonale e cila e caktoi një termin për t'i dëgjuar dy palët. Pas dëgjimit, gjykatësi tha se Gambia është një shtet shekullar në të cilin askush nuk ka të drejtë të përdorë gjuhë fyese ndaj të tjerëve. Ai pastaj tha se ahmedianët janë respektues të ligjit, ndërsa myslimanët e tjerë gjithmonë krijojnë probleme. Gjykatësi pastaj, e dënoi palën tjetër me 3500 dilasi³⁾ dhe ia dha 1000 dilasi si kompensim xhematit.

Tani unë do ta përfundoj fjalimin tim me një citat nga Mesihu i Premtuar^{as} i cili ka thënë:

"Për hir të Allahut, i këshilloj opozitarët tanë dhe u them se përdorimi i gjuhës së ndytë dhe fyerjet nuk janë vepër e mirë. Nëse besoni se unë jam gënjeshtar, atëherë shkoni në xhami, bini në sexhde dhe i luteni Allahut për t'më mallkuar; dhe nëse me të vërtetë jam gënjeshtar, lutjet tuaja do të pranohen. Lutuni, por gjithashtu mbani mend se edhe nëse do të derdhni aq shumë lot gjatë lutjeve tuaja sa t'ju shteren edhe sytë; ose të luteni aq shumë në sexhde sa që edhe hundët tuaja të hahen e të rrafshohen, lutjet tuaja nuk do të pranohen, sepse unë jam prej Allahut^{xhh}, dhe ai që më mallkon mua, do të mallkohet nga vetë Allahu^{xhh}".

Allahu u dhëntë urtësi këtyre njerëzve dhe u dhëntë mundësi ta njohin Imamin e Kohës^{as} dhe të kuptojnë se tani bota mund të shpëtohet vetëm duke besuar në Mesihun e Kohës.

³⁾ Valutë vendore

Note: This is an Albanian translation of Hazoor's Speech in Jalsa Salana UK, held on: **31 July 2004**

The topic of this Khutba is: **'The Progress of Ahmadiyyat during the year'**

This translation has been prepared by the members of **Kosovo Jam'at**